



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Syllabusi

Departmenti/Fakulteti/Njësia akademike:

Departamenti i Kompjuterikës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Titulli i kursit (lëndës mësimore) :

Interneti

Niveli dhe lloji i kursit:

Bachelor/obligative

Viti i studimeve dhe semestri:

Viti II-të, Semestri III

Numri i orëve në javë:

2+0+2

Kodi ose shifra e lëndës:

Vlera në kredi ECTS:

6

Koha/lokacioni:

E martë 9:00 – 10:30, Amfiteatri 408

Mësimdhënësit e kursit:

Prof. Dr. Ing. Lule Ahmedi

e-mail: lule.ahmedi@uni-pr.edu

Orari i konsultimeve:

E hënë dhe e martë 11:00 – 11:30

MSc. Korab Rrmoku, Asistent

MSc. Dardan Shabani, Asistent

Qëllimet e kursit (modulit):

Që studentët të aftësohen të kuptojnë konceptet themelore në lidhje me paradigmat programuese gjithnjë aktuale në Internet, si dhe të ofrojnë eksperiencë në dizajnimin dhe implementimin e sistemeve të bazuara në Ueb.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:

1. Të demonstroj njohuri fundamentale mbi teknologjitë tradicionale dhe atyre aktuale në World Wide Web.
2. Të zhvilloj Ueb aplikacione në praktikë - paraprakisht të përzgjedh arkitekturën, modelin dhe teknikat manipuluese të të dhënave që përkasin me natyrën e aplikacionit të cilin ai zhvillon.
3. Të dalloj përparësitë dhe të metat e paradigmës klient/server ndaj paradigmave tjera të shpërndarjes së komponenteve softverike në Ueb.

Metodologjia e mësimdhënjes:

Ligjërata, punime projektesh në grupe, prezentime, dhe ushtrime.

Literatura bazë:

[1] *Programming the World Wide Web (8th Edition)*. Robert Sebesta. Pearson, 2014.

[2] *Fundamentals of Web Development (2nd Edition)*. Randy Connolly, Ricardo Hoar. Pearson, 2017.

[3] *TCP/IP Illustrated, Volume 1: The Protocols (2nd Edition). Chapter 1: Introduction*. Kevin R. Fall, W. Richard Stevens. Addison-Wesley Professional Computing Series, 2011.

[4] Një numër i konsiderueshëm i burimeve në Ueb (fajlli *Resurset ne Ueb*)

Literatura shtesë e rekomanduar:

[5] *JavaScript: The Definitive Guide (6th Edition)*. David Flanagan. O'Reilly Media, 2011.

Plani i detajizuar i mësimit për një semestër:

Java e parë:

Hyrje

Java e dytë:

Interneti dhe WWW

Java e tretë:

HTML si pjesë e HTML5

Projekti - Pjesa 1

Java e katërt:

HTML si pjesë e HTML5 (vazhd.), Hyrje në CSS

Java e pestë:

Hyrje në CSS (vazhd.)

Java e gjashtë:

JavaScript (1/4)

Java e shtatë:

JavaScript (2/4)

Dorëzimi dhe prezentimi: Projekti - Pjesa 1

Projekti - Pjesa 2

Java e tetë:

JavaScript (3/4)

Java e nëntë:

JavaScript libraritë si jQuery (4/4)

Java e dhjetë:

Popullimi me baza të lehta të të dhënave në XML/JSON: RSS feeds, blogjet

Java e njëmbëdhjetë:

Multimedia përmes HTML5 (audio, video, canvas)

Dorëzimi dhe prezentimi: Projekti - Pjesa 2

Projekti - Pjesa 3

Java e dymbëdhjetë:

Funksionaliteti i shtuar në Ueb (Ueb shërbimet, wiki-të, tagging)

Java e trembëdhjetë:

CSS3, programimi i përgjegjshëm (ang. *responsive*) dhe pajisjet mobile

Java e katërmbdhjetë:

Kornizat e punës në anën e klientit si Bootstrap, Font Awesome, Lisa, Blueprint

Java e pesëmbdhjetë:

Ri-inxhinierimi i një aplikacioni në Ueb

Dorëzimi dhe prezentimi: Projekti - Pjesa 3

Provimi final

Metodat e vlerësimit (konform vendimit të departamentit):

I. Vlerësimi

1. Vijueshmëria në ligjërata dhe ushtrime: 10 pikë (5 pikë ligjërata + 5 pikë ushtrime).
2. Projekti: 30 pikë, dhe
3. Pjesa me shkrim – testi final: 60 pikë.

II. Notimi

- Për të kaluar provimin, studenti duhet të ketë minimum nga testi final $\frac{1}{2}$ e pikëve (pra 30 nga 60 pikë) dhe shuma nga pika 1, 2 dhe 3 nga vlerësimi duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se 50 pikë.

III. Ruajtja e pikëve

- Pikët e grumbulluara gjatë semestrit, konform vendimit të Këshillit të FIEK-ut, i ruhen studentit një vit. Mbas një viti, pikët kthehen në zero, ose studenti (përsëritës) duhet t'a ndjekë lëndën nga fillimi (sikurse studentet që e ndjekin për herë të parë).

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: